



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

**MINISTRIA E
ADMINISTRIMIT TË
PUSHTETIT LOKAL**

**ANALIZË Ë REALIZIMIN E
DETYRAVE TË KOMUNAVE NGA
PVNMSA PËR PERIUDHËN JANAR -
DHJETOR 2013**

**DEPARTAMENTI PËR INTEGRIME EVROPIANE DHE KOORDINIM TË
POLITIKAVE**

Përmbajtja

Qëllimi i analizës	1
Vlerësim i përgjithshëm i realizimit të detyrave të komunave nga PVMSA 2013.....	4
Kriteret politike.....	Error! Bookmark not defined.
Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve.....	6
Aftësia për të përballuar obligimet që dalin nga MSA-ja.....	Error! Bookmark not defined.
Bujqësia	9
Kontrolli financiar, punësimi, politika sociale dhe politika e shëndetit publik.....	10
Mjedisi dhe ndryshimet klimatike.....	10
Bashkëpunimi ndërkufitar.....	11
Konkluzionet	11

Qëllimi i analizës

Kjo analizë ka për qëllim vlerësimin e realizimit të detyrave të komunave nga PVMSA komunale 2013, përkatësisht të Zyrave Komunale për Integritet Evropian, në realizimin e detyrave të dala nga Plani i Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit. Analiza përfshin disa nga pikat më kryesore, si: vlerësimi i përgjithshëm i cilësisë së raportimit të komunave, ofrimi i udhëzimeve administrative dhe rregulloreve nga niveli qendror në ngritjen e kapaciteteve, trajnimet dhe performanca e komunave, të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve, bujqësia dhe ambientit si dhe konkluzionet.

Analiza është shkruar duke u bazuar në përgjigjet e komunave në pyetjet e dërguara. Përgjigjet e dërguara nga komunat janë klasifikuar dhe analizuar me kujdes, me qëllim që duke u bazuar në ato të dhëna të nxirren gjetjet dhe konkluzionet e përfshira në raport. Gjatë hartimit të raportit kemi identifikuar disa nga komunat të cilat nuk kanë ofruar përgjigje për një pjesë të pyetjeve të dërguara. Në këtë drejtim, janë shfaqur vështirësi për hartuesit e raportit gjatë përpilimit dhe vlerësimit të tij, në krahasimin në mes komunave dhe në nxjerrjen e konkluzioneve finale.

Vlerësim i përgjithshëm i cilësisë së raportimit të komunave

Në bazë të analizës dhe vlerësimit të Raportit vjetor për zbatimin e Planit të Veprimit Komunal për NMSA-në 2013, është vlerësuar se komunat në përgjithësi kanë shënuar një progres të theksuar në çështjen e raportimit dhe ofrimit të të dhënave, përveç disa komunave për të cilat ende ka hapësirë për përmirësim. MAPL-ja ka dërguar në adresë të komunave pyetësin për plotësim i cili është nxjerr nga Plani i Veprimit për negocimin e MSA-së. Në këtë drejtim, një pjesë e konsiderueshme e komunave të Republikës së Kosovës kanë raportuar për periudhën janar –dhjetor 2013. Marrë në përgjithësi, nga 38 komunat e Kosovës vetëm 5 komuna kanë raportuar. Gjithashtu, është vërejtur se mënyra e raportimit të komunave në dhënien e përgjigjeve është mikse, ku një pjesë e përgjigjeve janë konkrete, pjesa tjetër e përgjigjeve i përket mënyrës së përgjithësuar, ndërkaq në pjesën tjetër nuk ka fare përgjigje.

Raporti nënvizon kontinuitetin e punës së komunave, sukseseve, të arriturave dhe paraqitjes së sfidave në përmbushjen e obligimeve. Në kuadër të raportit, fokus i veçantë i është dhënë forcimit të kapaciteteve të administratës në nivelin lokal (përfshirë edhe komunat e sapoformuara) përmes ofrimit të udhëzimeve administrative dhe rregulloreve nga niveli qendror në ngritjen e kapaciteteve, zbatimit të kurrikulës në gjuhën romë, sigurimin e qasjes në arsim dhe luftimin e braktisjes së shkollimit, decentralizimin e fondit për ri-integrim, hartimi i politikave, planeve dhe programeve zhvillimore për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, përmirësimi i infrastrukturës në zonat rurale, shfrytëzimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, zhvillimi i auditimit të brendshëm dhe menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK) në sektorin publik në harmoni me standardet dhe praktikat ndërkombëtare, ofrimi i shërbimeve shëndetësore për të gjitha komunitet minoritare, me prioritet komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas, zbatimi i politikave mjedisore me qëllim të përmirësimit të gjendjes së mjedisit dhe programet e bashkëpunimit ndërkufitar.

1. Forcimi i kapaciteteve të administratës në nivelin lokal

Gjatë vitit 2013 ka vazhduar forcimi i kapaciteteve të administratës në nivelin lokal. Posaçërisht komunat e sapoformuara janë përkrahur nga niveli qendror në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve administrative. Niveli qendror ka ofruar përkrahje për nivelin lokal përmes ofrimit të udhëzimeve lidhur me ngritjen e kapaciteteve administrative, si dhe duke u kujdesur për nivelin e zbatimit të tyre nga niveli lokal. Kur janë përgjigjur në pyetjet e pyetësorit lidhur me udhëzimet që kanë pranuar nga niveli qendror, komunat kanë nënkuptuar në mënyrë specifike “*udhëzime administrative*” dhe “*rregullore*” të ofruara nga niveli qendror, përkundër pyetjes konkrete e cila është e formuluar dhe parashtruar në Planin e Veprimit për Negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Shumica e komunave janë përgjigjur se kanë pranuar një numër të konsiderueshëm të udhëzimeve nga niveli qendror gjatë vitit 2013. Komunat tjera kanë pranuar më pak udhëzime, kurse disa nga to nuk kanë ofruar përgjigje në këtë pyetje. Të gjitha komunat, të cilat janë përgjigjur në pyetjen lidhur me nivelin e zbatimit të udhëzimeve të pranuar, janë përgjigjur se të gjitha udhëzimet e pranuar nga niveli qendror janë të zbatueshme. Sa i përket kësaj çështjeje, duhet të kemi parasysh se komunat iu janë referuar udhëzimeve administrative dhe rregulloreve të caktuara e jo udhëzimeve të përgjithshme lidhur me ngritjen e kapaciteteve administrative, ashtu siç është nënkuptuar në pyetjet e dërguara.

Komunat kanë ofruar trajnime për zyrtarët e tyre lidhur me ngritjen e kapaciteteve administrative. Gjatë vitit të kaluar, janë ofruar gjithsej 261 trajnime, shumica nga të cilat janë ofruar brenda vendit. Trajnime të ngjashme janë ofruar edhe nga ministritë. Numri i trajnimeve të ofruara nga niveli qendror variron nga më pak se dhjetë në disa komuna, deri në 71 trajnime të ofruara për zyrtarët komunalë në komunën e Lipjanit. Trajnime për ngritjen e kapaciteteve të administratës lokale janë ofruar edhe nga disa organizata ndërkombëtare si KE, USAID, GIZI, OSBE. Numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë të komunave të cilët kanë marrë pjesë në këto trajnime është 1088.

Udhëzimet e ofruara nga niveli qendror dhe posaçërisht trajnimet e ofruara lidhur me ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e tyre, kanë rezultuar me ngritjen e kënaqshme të performancës në punë dhe në ofrimin e shërbimeve administrative nga ana e pushtetit lokal. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe thjeshtëzimi i procedurave administrative, duke e bërë kryerjen e tyre më praktike dhe më të shpejtë. Përmirësime vërehen edhe sa i përket sigurisë së dokumenteve të lëshuara nga niveli lokal, kjo është arritur pjesërisht përmes instalimit dhe mirëmbajtjes të programeve përkatëse nga ana e nivelit qendror. Kjo ka rezultuar me ngritjen e besueshmërisë për dokumentet e lëshuar nga komunat. Përmirësime janë bërë edhe në fushën e arkivimit të dokumenteve nga niveli komunal. Me Vendimin e Qeverisë nr. 01/75 të datës 23.05.2012 është themeluar Zyra e Mitrovicës së Veriut. Edhe pse janë mbajtur zgjedhjet dhe konfirmuar rezultatet për kuvendim komunal dhe kryetarin e komunës, pushteti lokal nuk është konsoliduar ende për shkak se kryetari i zgjedhur ka dështuar në dhënien e betimit. Të gjitha shërbimet komunave vazhdojnë të ofrohen nga Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut.

2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve

Sa i përket të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së minoriteteve, çështjet më të ndjeshme përshijnë zbatimin e kurrikulës në gjuhën rome, sigurimin e qasjes në arsim për të gjithë nxënësit, posaçërisht ata nga komunitetet jo shumicë si dhe luftimin e fenomenit shqetësues të braktisjes së shkollimit. Në një numër të konsiderueshëm të komunave nuk ka kurrikulë në gjuhën rome. Në disa komuna nxënësit e komuniteteve RAE nuk kanë shprehur interesim që të mësojnë në gjuhën rome, ata e konsiderojnë si më të përshtatshëm që të vazhdojnë mësimin në gjuhën shqipe. Ka pak komuna në të cilat nuk ka nxënës të këtyre komuniteteve, kurse në komunën e Gjilanit nxënësit rom mësimin e ndjekin në shkollat serbe dhe punojnë me kurrikulë të R. Serbisë duke mos e respektuar kurrikulën e MASHT-it. Shqetësuese është edhe numri i vogël i mësuesve të gjuhës rome. Në shumicën e komunave nuk ka asnjë mësues të gjuhës rome. Komuna e

Prizrenit ka 4 mësues, kurse komuna e Kamenicës dhe Lipjanit kanë vetëm nga 1 mësues të gjuhës rome. Vetëm komuna e Gjilanit ka 20 mësues në gjuhën rome.

Po ashtu, është shqetësuese edhe numri i madh i rasteve të braktisjes së shkollimit nga nxënësit. Në shumicën e komunave ka me dhjetëra raste të braktisjes së shkollimit nga nxënësit. Në disa komuna ky numër shkon deri në disa qindra raste të braktisjes së shkollimit. Një numër komunash nuk kanë ofruar përgjigje në pyetjen lidhur me numrin e nxënësve që kanë braktisur shkollimin. Numri i këtyre rasteve pasqyrohen në tabelën më poshtë. Vetëm një pjesë e vogël e nxënësve që kanë braktisur shkollimin, janë rikthyer në shkollë pastaj.



Komunat, sidomos ato në të cilat është më i theksuar ky fenomen, kanë marrë një numër masash për të parandaluar dhe luftuar këtë fenomen negativ. Një nga masat e ndërmarra është ofrimi i orëve shtesë të mësimin intensiv për të ndihmuar në kthimin në shkollë. Një tjetër masë e ndërmarrë është edhe formim i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit (EPRBM) të themeluara sipas UA 7/2011 të MASHT-it. Një tjetër masë e ndërmarrë për të luftuar braktisjen e shkollimit, dhe posaçërisht për të përkrahur rikthimin në shkollë të nxënësve që kanë braktisur shkollën, është përmes bashkëpunimit të ngushtë me Qendrat për Punë Sociale nëpër komuna.

3. Decentralizimi i fondit për ri-integrim

Disa nga masat kryesore të ndërmarra për të përmirësuar aftësinë për të përballuar obligimet që dalin nga MSA-ja përfshijnë decentralizimin e fondit për ri-integrim, thjeshtësimin e procedurave të aplikimit për këtë fond dhe përmirësimin e bashkëpunimit në mes pushtetit qendror dhe lokal. Në përgjigjet e dërguara, shumica dërrmuese e komunave shprehen se ata ende nuk menaxhojnë me fondin për ri-integrim. Komunat kanë ofruar përgjigje të detajizuara lidhur me numrin e kërkesave të dorëzuara dhe lidhur me numrin e atyre të miratuara për plane të biznesit, renovime të shtëpive, biznese, mjete mjekësore, mjete higjienike e të ngjashme.

Të rikthyerit janë ndihmuar edhe në fusha tjera si në: arsim, gjuhë, trajnime profesionale dhe punësim. Kujdes i veçantë nga ana e komunave i është kushtuar kyçjes në arsim të fëmijëve të familjeve të kthyer. Po ashtu, janë organizuar trajnime për zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive të tyre në gjuhën shqipe me qëllim që t'u mundësohet kyçja dhe vazhdimi i suksesshëm i shkollimit në gjuhën shqipe në Kosovë. Së këndejmi është punuar edhe në ofrimin e trajnimeve për punë dhe gjetjen e mundësive për punësim për të rikthyerit, me qëllim që tu mundësohet gjenerimi vetanak i të hyrave dhe ri-integrimi i plotë i tyre në shoqërinë kosovare. Një pjesë e këtyre trajnimeve dhe përkrahjeve janë ofruar edhe nga disa organizata ndërkombëtare. Vërehet gjithashtu një shtim i bashkëpunimit në mes pushtetit qendror dhe atij lokal në trajtimin e të rikthyerve. Një kujdes më i veçantë, sa i përket kësaj problematike, i është kushtuar të rikthyerve të komuniteteve jo shumicë.

4. Bujqësia

Në fushën e bujqësisë, shumica e komunave tashmë e kanë hartuar master plani mbi zhvillimin e bujqësisë. Në komunën e Rahovecit në kuadër të programit zhvillimor të Bujqësisë, është hartuar programi në mbështetjen e fermerëve me ndarjen e subvencioneve dhe granteve për sektorët e lavërtarisë dhe të perimeve. Më shumë se gjysma komuna tashmë kanë themeluar dhe funksionalizuar Grupin e Veprimit Lokal, në disa ende nuk janë themeluar këto grupe, kurse në disa tjera janë themeluar por ende nuk janë funksionalizuar. Komunat kanë ofruar mbështetje për sektorin e bujqësisë, kryesisht përmes granteve dhe subvencioneve të dhëna fermerëve. Këto kanë pasur për qëllim të mbështesin modernizimin e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimin e këtij sektori.

Grantet dhe subvencionet e ofruara kanë pasur efekt të drejtpërdrejtë në zhvillimin e sektorit të bujqësisë si p.sh thertorja e kafshëve “Geberland” dhe qumështoren “Golaj” në komunën e Gjakovës. Këto grante dhe subvencione kanë ndikuar në rritjen e produktivitetit, përmirësimin e cilësisë së produkteve bujqësore, shtimin e numrit të të punësuarve në sektorin e bujqësisë e të tjera, duke pasur kështu një efekt afatgjatë në zhvillimin e këtij sektori në Kosovë. Komunat kanë punuar edhe në përmirësimin e infrastrukturës rurale, duke e bërë më të lehtë për bujqit qasjen dhe tokat e punuara dhe transportimin e produkteve bujqësore. Një tjetër aspekt nga i cili kanë përfituar bujqit, është investimi nga ana e komunave në sistemet e ujitjes. Dëmtimi i vazhdueshëm i sipërfaqeve pyjore nga prerjet ilegale dhe zjarret e pakontrolluara, ka qenë shqetësim tjetër i pushtetit lokal, i cili ka marrë masa të ndryshme adekuate për të evituar këto dhe për të siguruar menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve.

5. Kontrolli financiar, punësimi, politika sociale dhe politika e shëndetit publik

Duke përjashtuar komunat e Hanit të Elezit dhe Kllokotit, të gjitha komunat tjera kanë themeluar Njësinë Komunale për Auditim të Brendshëm. Në shumicën e komunave gjithashtu është në proces të themelimit Komiteti për Auditim të Brendshëm. Komunat kanë nga disa auditorë të brendshëm, disa nga këta janë të certifikuar e disa janë në proces të certifikimit. Si rezultat i punës së auditorëve të brendshëm, nga disa dhjetëra rekomandime janë dhënë, një pjesë e tyre tashmë janë pranuar dhe zbatuar.

Punësimi, politikat sociale dhe politikat e shëndetit publik janë disa nga fushat për të cilat komunat kanë ndërmarrë masa duke nxjerrë strategji komunale, përfshirë edhe OJQ-të në ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale. Njëkohësisht, komunat kanë miratuar edhe Planin e Veprimit në të cilin përfshihen komunitetet pakicë (në këtë rast komunitetit RAE) të cilët kanë qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore sikurse të gjitha komunitet e tjera.

6. Mjedi dhe ndryshimet klimatike

Çështjet lidhur me mjedisin jetësor dhe ndryshimet klimatike janë fusha prioritare dhe jetike për vendin. Ato përfshijnë disa nënfusha të tjera në të cilat përfshihet ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në sektorin e mjedisit, trajnimet për zbatimin e legjislacionit mjedisor, trajnimet për inspektorët komunal të ambientit, trajnimet për zyrtarët komunal në trajtimin e vendbanimeve jo - formale, për procesin e hartimit të Planeve Rregulluese Urbane, zbatimin e planit lokal të veprimit në mjedis, planet komunale për menaxhimin e mbeturinave etj.

Pushteti lokal dhe qendror kanë bashkëpunuar ndërmjet vete në sektorin e mjedisit duke zhvilluar projekte të ndryshme mbi mbrojtjen e ambientit dhe duke mbajtur aktivitete me qëllim të pastrimit të ambientit. Po ashtu, zbatimi i planit lokal të veprimit

në mjedis dhe planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, ndikojnë dukshëm në komuna dhe japin efektin pozitiv të menaxhimit të qëndrueshëm të ambientit dhe krijimit të hapësirave të reja gjelbëruese. Si shkaktar kryesor për ndotjen e ambientit në komuna konsiderohen gurëthyesit të cilët nuk respektojnë ligjet dhe aktet nënligjore.

7. Programet e bashkëpunimit ndërkufitar

Shumica nga komunat kanë filluar ose janë duke zbatuar projekte të përbashkëta të bashkëpunimit ndërkufitar. Në komunën e Gjilanit Këshilli i Evropës hapi Zyrën e Agjencionit për Demokratizim Lokal në Komunën e Gjilanit, që nga atëherë Komuna e Gjilanit është pjesë e Bashkëpunimit Ndërkufitar. Edhe komuna tjera si Kamenica, ka potencuar se në bashkëveprim me gjimnazin janë binjakëzuar me një komunë në Turqi dhe në kuadër të kësaj kanë mbajtur takime me MAPL-në lidhur me bashkëpunimet ndërkufitare dhe binjakëzimet, si dhe me promovimin e ligjit lidhur me këtë çështje. Komuna Hani i Elezit ka marrëveshje të bashkëpunimit me komunat e Republikës së Maqedonisë si me komunën e Sopishtës, Haraqinës, Studeniqanit, Shutkës dhe ka realizuar vizita reciproke me komunat në fjalë. Edh komunat tjera kufitare janë përfshirë nënprojekte të bashkëpunimit ndërkufitar. Mesatarisht komunat kanë vlerësuar dhe përzgjedhur disa dhjetëra projekte të përbashkëta ndërkufitare.

Konkluzionet

- Të gjitha komunat kanë pranuar udhëzime nga niveli qendror përveç komunave Kamenicë, Skenderaj dhe Istogu të cilat nuk kanë pranuar asnjë udhëzim nga niveli qendror;
- Komunat dhe ministritë kanë ofruar trajnime të ndryshme për nivelin lokal;
- Pjesëmarrja e nëpunësve civil në trajnime është i kënaqshëm;
- Ngritja e performancës në punë dhe në ofrimin e shërbimeve në nivelin lokal është e evidente;

- Komunat kanë shënuar progres në thjeshtëzimin dhe shkurtimin e kohëzgjatjes së procedurave;
- Ngritja e sigurisë dhe besueshmërisë së dokumenteve të lëshuara nga komunat kanë arritur nivel të kënaqshëm;
- Në komuna ende mbetet i lartë numri i nxënësve të cilët kanë braktisur shkollën fillore, të mesme të ultë dhe atë të lartë;
- Komunat ende nuk menaxhojnë me fondin për ri-integrim;
- Në komuna janë dorëzuar një numër i madh i kërkesave për fondin për ri-integrim;
- Të kthyerit në komuna janë ndihmuar në punësim, arsim, gjuhë dhe trajnime profesionale;
- Bashkëpunimi në mes të nivelit qendror dhe atij lokal në fushën e fondit për ri-integrim është përmirësuar;
- Në komunën e Ferizajt, Klinës dhe Kllokotit ende nuk është hartuar programi zhvillimor për sektorin e bujqësisë;
- Grupi i Veprimit Lokal nuk është i themeluar në komunën e Kamenicës dhe Kllokotit;
- Në komuna, niveli i dënimeve për kundërvajtje dhe vepra penale për dëmtuesit dhe shfrytëzuesit ilegal të pyjeve është i lartë;
- Dëmet e shkaktuara nga zjarret në komuna është i konsiderueshëm;
- Komuna e Hanit të Elezit, Klinës, Fushë, Kosovës, Deçanit, Graçanicës, Vitisë dhe Kllokotit nuk i kanë të themeluar Qendrat për Këshilla Rurale dhe Këshilla për Biznese;
- Njësia Komunale për Auditim të Brendshëm nuk është themeluar në komunën e Hanit të Elezit dhe Kllokotit;
- Komunat Gjakovë, Lipjan, Istog, Shtërpcë dhe Hani i Elezit nuk e kanë të themeluar Komitetin e Auditimit të Brendshëm;
- Komunat kanë përfshirë OJQ-të në ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale;

- Në të gjitha komunat, komunitetet pakicë kanë qasje të barabartë në shërbimet shëndetësore;
- Është ngritur bashkëpunimi ndërmjet ministrive dhe komunës në sektorin e mjedisit;
- Komuna e Gjakovës, Lipjanit, Dragashit, Fushë Kosovës, Mamushës, Podujevës dhe Klllokotit nuk e kanë planin për menaxhimin e mbeturinave;